

Nr. Prot.058/B/18

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AUTORITETI RREGULLATIV I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE REGULATORNI AUTORITETI ZA ELEKTRONSKE I POŠTANSKE KOMUNIKACIJE REGULATORY AUTHORITY OF ELECTRONIC AND POSTAL COMMUNICATIONS	
Nr./Br./No.	058/B/18
Nr. Faq./Bz. Str./Fol. Pg.	2
Data/Datumi/Date	02.11.2018
PRISHTINË - PRISTINA - PRISHTINA	

VENDIM Nr. 1269

Për

Fillimin e Procesit të Konsultimit Publik

Për

'Planet e shpërndarjes dhe shfrytëzimit të brezeve të frekuencave 800 MHz, 900 MHz dhe 1800 MHz për shërbimet mobile të radio komunikimeve IMT'

Në mbështetje të nenit 3 paragrafi 1) dhe 2), nenit 9 paragrafi 3), nenit 10 paragrafi 12), nenit 45 paragrafi 1) dhe paragrafi 2), nenit 79 paragrafët 1) dhe 2), nenit 82 paragrafët 1) dhe 3) të Ligjit për Komunikime Elektronike Nr. 04/L-109 (tutje referuar si - Ligji ose LKE), nenit 20 të Rregullores së Brendshme (Ref. Nr.Prot.161/06) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (tutje referuar si - Autoriteti ose ARKEP), Bordi i Autoritetit i përbërë nga:

- 1) z. Kreshnik Gashi, Kryetar
- 2) z. Nijazi Ademaj, Anëtar
- 3) z. Hazir Hajdari, Anëtar
- 4) z. Bahri Anadolli, Anëtar
- 5) z. Shqiprim Pula, Anëtar

në mbledhjen e 32-të me radhë të mbajtur me datë 02 Nëntor 2018, pas shqyrtimit të materialeve të përgatitura nga Departamenti për Menagjimin e Frekuencave -DMF për 'Planet e shpërndarjes dhe shfrytëzimit të brezeve të frekuencave 800 MHz , 900 MHz dhe 1800 MHz për shërbimet mobile të radio komunikimeve IMT', nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet fillimi i procesit të konsultimit publik për dokumentet si në vijim:
 - a. Plani i shpërndarjes dhe shfrytëzimit të brezit të frekuencave 791-821/832-862 MHz për rrjetat e komunikimeve mobile/fikse (MFCN).
 - b. Planin i shpërndarjes dhe shfrytëzimit të brezit të radio frekuencave 880-915 & 925-960 MHz, për sistemet celulare tokësore GSM, UMTS, LTE , WIMAX dhe IoT, dhe
 - c. Plani i shpërndarjes dhe shfrytëzimit të brezit të radio frekuencave 1710- 1785 & 1805 - 1880 MHz, për sistemet celulare tokësore GSM, UMTS, LTE , WIMAX dhe IoT.

Faqe 1 nga 2



- II. Procesi i konsultimit me palët e interesit fillon më datë: **22 Nëntor, 2018** dhe përfundon më **21 Dhjetor 2018**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Ligji, respektivisht neni 10 (*Kompetencat e Autoritetit*) përkufizon kompetencat e Autoritetit për menaxhimin e resurseve dhe rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike.

Neni 82 i Ligjit përkufizon se Autoriteti gjatë aprovimit të akteve normative duhet t'i publikoj ato në pajtim me kushtet dhe procedurat e vendosura nga Autoriteti, duke ua ofruar mundësinë personave të interesuar që në afat të arsyeshëm kohor të shprehin pikëpamjet e tyre.

Andaj, Bordi i Autoritetit ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

Prishtinë, 22/11/2018

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Kreshnik Gashi
Kryetar i Bordit



Aktvendimi i dërgohet:

- Operatorëve (ndërmarrësve) të rrjetit dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike;
- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik/Departamenti i Postë Telekomunikacionit;
- Komisioni i Pavarur për Media- KPM,
- Departamenteve DMF, DRMI dhe DL të ARKEP
- Arkivës së Autoritetit.